



Planuar / Dorezuar Prilidjen / Prilidato Received / Delivery	06.06.2023	viti god year	3
Organ / Njësia Org. / Jedinica Org. / Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot. No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHK/4605/2023			113



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.666/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.666/2023 të datës 24.04.2022, të parashtruar nga ankuesja _____ në çështjen juridike “kundërshtim i masës disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 06.06.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet si e bazuar** ankesa më numër A.nr.666/2023 e datës 24.04.2022, e parashtruar nga ankuesja _____
- II. **Anulohet** masa disiplinore “Vërejtje” e shqiptuar ndaj ankuese përmes shkresës me numër protokollit 37/2 të datës 24.03.2022, të Drejtorit të Qendrës për Punë Sociale në Komunën e Rahovecit,
- III. **Obligohet** Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Rahovecit, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të largoj nga dosja personale e nëpunëses civile si dhe regjistri përkatës masën disiplinore e anuluar si në pikën II.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja _____ (*tutje vetëm ankuesja*), e punësuar në Komunën e Rahovecit, më datë 24.04.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër masës disiplinore “Vërejtje” të shqiptuar nga Drejtori i Qendrës për Punë

Sociale në Komunën e Rahovecit, përmes shkresës me numër 37/2 të datës 24.03.2022, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës (*me tej referuar Këshilli*), bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 02.05.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Rahovecit, ndërsa kjo e fundit me datë 16.05.2023, ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 3749/2023 të datës 24.04.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e datës 30.12.2022 me numër 01/52/22 të nxjerr nga Drejtori i Qendrës për Punë Sociale në Komunën e Rahovecit; Orarin i kujdestarisë në Qendrën për Punë Sociale në Rahovec; E-mail zyrtar i datës 24.03.2023 ; E-mail zyrtar i datës 24.03.2024; shkresë me numër protokollit 37/2 e datës 24.03.2023 për shqiptimin e masën disiplinore "Vërejtje", Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 02.05.2023; Përgjigjen në ankesë nga organi i punësimit të datës 16.05.2023; Arsyeya e vërejtjes-shkresë e datës 11.05.2023; Akt emërimit 01/Nr.2524 të datës 18.06.2013; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Zyrtar i Shërbimeve Sociale të datës 22.11.2012; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2022 të datës 22.01.2023 të ankueses; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 të datës 28.01.2022 të ankueses dhe Vendimin me numër protokollit 215 të datës 18.05.2022 të Kryetarit të Komunës së Rahovecit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi së ankesa e ankueses është e bazuar, *sepse:*

Nga administrimi i provave materiale të lëndës Kolegji ka gjetur së ankuesja është e punësuar në Komunën e Rahovecit dhe së e njëjta sipas Aktit të Emërimit 01/Nr.2524 të datës 18.06.2013 është emëruar dhe ushtron pozitën e punës më titull "*Zyrtare për Shërbime Sociale*" në Sektorin e Qendrës për Punë Sociale.

Me tutje nga provat e lëndës rezulton së Drejtori për Pune Sociale përmes shkresës me numër protokollit 37/2 të datës 24.03.2023, ka shqiptuar ndaj ankueses masën disiplinore "*Vërejtje*", me arsyetim së ankuesja ka refuzuar zbatimin e urdhrorit të Drejtorit të QPS, ashtu që me datë 23.03.2023 nuk i është bashkëngjitur aksionit të përbashkët të Policisë së Kosovës dhe QPS në Rahovec, për largimin e lypësve nga rrugët në qytetin e Rahovecit.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, pretendon së masa disiplinore e kundërshtuar me ankesë është e pa bazuar sepse organi i kujdestarisë funksionon në përbërje prej katër zyrtareve çdo muaj, dhe se në muajin mars nuk kam qenë pjesë e këtij komisioni.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, respektivisht kapitullin IV lidhur me Disiplinën në Shërbim Civil, si dhe Rregulloren (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, me


të cilën është rregulluar në mënyrë të detajuar procedura dhe masat disiplinore për nëpunësit civil. Ndërsa në kuptim të kompetencës për shqiptimin e masave disiplinore, Kolegji ju referua nenit 47 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë me të cilin shprehimisht është përcaktuar se: 1.Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil, ndërlidhur me këtë neni 48 paragrafi 1 i po këtij ligji ka përcaktuar se: 1.Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë”, andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore dhe bazuar në përshkrimin e detyrave të punës të ankueses, Kolegji konstaton së e njëjta i përgjigjet Udhëheqësit të Sektorit për Shërbime Sociale në Qendrën për Punë Sociale në Rahovec, kurse bazuar në Vendimin me numër protokolli 2125-376 të datës 18.05.2022 të Kryetarit të Komunës së Rahovecit, Znj. Goneta Mustafa është autorizuar që të ushtroj detyrat e Udhëheqëses së Sektorit për Shërbime Sociale, kështu që mbi bazën e këtyre fakteve rezulton së Drejtori i Qendrës për Pune Sociale në Komunën e Rahovecit nuk ka pasur kompetencë për të shqiptuar ndaj ankueses masën disiplinore “vërejtje”, sepse siç u konstatua me lart i njëjti nuk është mbikëqyrës i drejtpërdrejt i ankueses, rrjedhimisht ne rastin konkret masa disiplinore “vërejtje” mund të shqiptohet nga Udhëheqësi i Sektorit për Shërbime Sociale në Qendrën për Punë Sociale në Rahovec.


Referuar nenit 52 paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative një akt administrativ i nxjerrë nga organi i cili nuk ka pasur kompetencë konsiderohet akt i paligjshëm, kështu që nisur nga fakti së masa disiplinore e atakuar me ankesë është shqiptuar nga organi jo kompetent, Kolegji nuk u lëshua në konstatimin e ligjshmërisë materiale të pretendimeve ankimore të ngritura në ankesë.

Theksuar si më lart, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.666/2023

Ardita Perçuku-Shyti

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet“

- Ankueses
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Rahovecit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.